



**KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT
INSTITUTI PARLAMENTAR**

PLANI STRATEGJIK
I INSTITUTIT PARLAMENTAR 2024-2028

Dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

1. Мисија на Парламентарниот институт.....	4
2. Визија на Парламентарниот институт	4
4. Извршување, следење и оценување	4
5. Стратешки цели.....	5
6. Матрица на стратешки цели	6

Të nderuar,

Instituti Parlamentar është pjesë themelore e Shërbimit të Kuvendit në rolin e sigurimit të informacioneve për pushtetin ligjvënës.

Ne, me krenari u shërbejmë deputetëve në mbështetje të zbatimit të kompetencave të tyre në bazë të parimeve të paanësisë, objektivizmit dhe përmbajtjes së afatit.

Ekipi ynë përbëhet nga nëpunës profesionalë, të cilët sigurojnë shërbime inovative, mënyrë efikase dhe etike në mjedis inkluziv pune ku janë të vlerësuar dhe të respektuar.

Qëllimet strategjike të Institutit Parlamentar për periudhën 2024-2028 janë: Shtëpi ligjvënëse e informuar, Kuvendi për të gjithë, Parlament digjital dhe Institut Parlamentar bashkëkohor

Realizimi i prioriteteve do të mbështetet nga infrastruktura moderne elektronike dhe informatike.

Ndjekja e zbatimit të prioriteteve strategjike do të jetë e përhershme, nëpërmjet raporteve vjetore.

Instituti Parlamentar mbetet i përkushtuar ndaj obligimeve të veta ligjore që ta përforcojë kapacitetin ligjvënës dhe mbikëqyrës analitik-hulumtues.



Zlatko Atanasov
Udhëheqës i Institutit Parlamentar

1. Misioni i Institutit Parlamentar

Sigurimi në kohë i shërbimeve dhe informacioneve të paanshme, objektive dhe në dispozicion për pushtetin ligjvënës.

2. Vizioni i Institutit Parlamentar

Qendër profesionale kërkimore dhe arsimore që ofron hulumtime dhe shërbime objektive, cilësore dhe novatore për deputetët dhe përdoruesit e tjerë, duke kontribuar kështu në forcimin e funksionit legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit dhe promovimin e kulturës së hapjes së shtëpisë ligjvënëse për qytetarët.

3. Vlerat e Institutit Parlamentar

- Integritet - ne jemi të ndershëm, etikë, të respektuar, të pavarur, objektivë dhe profesionalë.
- Llogaridhënie - ne mbajmë përgjegjësi para institucionit, përdoruesve të shërbimeve tona dhe njëri ndaj tjetrit.
- Mësim - ne mësojmë vazhdimisht dhe e përcjellim njohurinë tonë.
- Inovacione - ne jemi inovativë dhe synojmë të krijojmë të ardhme më të mirë.
- Përdorues - jemi të fokusuar ndaj nevojave të përdoruesve të shërbimeve tona.

4. Zbatim, ndjekje dhe vlerësim

Monitorimi i zbatimit të Planit Strategjik 2024 - 2028 do të kryhet vazhdimisht në kuadër të Institutit Parlamentar nëpërmjet strukturave drejtuese të kolegjiumeve të rregullta mujore të përgjithshme në nivel të Institutit Parlamentar, si dhe takimeve koordinuese sektoriale dhe tematike.

Në bazë të këtij Plani Strategjik, Instituti Parlamentar do t'u propozojë anëtarëve të Këshillit Drejtues, Planin Vjetor të Aktiviteteve, në përputhje me nenin 42 të Ligjit për Kuvendin.

Shpenzimet për qëllimet dhe aktivitetet do të bashkohen në kontributin e Kuvendit në qarkoren buxhetore për planifikimin e shpenzimeve të shfrytëzuesve buxhetorë në përputhje me Ligjin për buxhetet dhe Ligjin për Kuvendin.

Në suazat e strukturës të vendosur institucionale të Institutit Parlamentar do t'u dorëzojë raport vjetor operativ dhe financiar anëtarëve të Këshillit Drejtues.

5. QËLLIMET STRATEGJIKE

Plani strategjik 2024-2028 përmban 4 qëllime strategjike për realizimin e misionit të Institutit Parlamentar:

I. SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR

- Janë përpiluar dhe shpërndarë hulumtime dhe analiza të sakta dhe objektive për deputetët.
- Shërbime të siguruar për edukimin dhe informimin e shtëpisë ligjvënëse.
- Janë siguruar shërbime bashkëkohore, arkivore, referente, bibliotekare dhe qasje te të dhënat.

II. KUVENDI PËR TË GJITHË

- Promovim i kulturës së transparencës.
- Përfshirja dhe informimi i të gjitha kategorive të qytetarëve

III. PARLAMENT DIGJITAL

- Hapje dhe qasje në shërbimet e Institutit Parlamentar
- Digjitalizim i të dhënave dhe statistikave

IV. INSTITUT PARLAMENTAR BASHKËKOHOR

- Qendër e rrjetëzuar për hulumtime, informim dhe edukim.
- Ekipim, vendosje hapësinore dhe përforcim i kapaciteteve administrative.

6. Matrica e qëllimeve strategjike

QËLLIME STRATEGJIKE		VLERA TË CILAT DUHET TË ARRIHEN NË PERIUdhËN 2024-2028
1.	SHTËPI LIGJVËNËSE E INFORMUAR	
1.1	Janë përpiluar dhe shpërndarë hulumtime dhe analiza të sakta dhe objektive për deputetët.	
		100% kërkesa të përgjigjura për informacione të parashtruara na deputetët në afatin e kërkuar.
		400 hulumtime dhe analiza me kërkesë të deputetëve.
		500 analiza dhe hulumtime të përpiluara dhe shpërndara me iniciativë personale.
		100% materiale në dispozicion në formë elektronike nëpërmjet “E-parlamentit” dhe sistemit RMS.
		30% e deputetëve nga përbërja aktuale e deputetëve, përdorues të shërbimeve të IP-së.
1.2	Shërbime të siguruar për edukimin dhe informimin e shtëpisë ligjvënëse.	
		20 evenimente edukative për deputetët

		20 evenimente për Shërbimin e Kuvendit
		10 evenimente për asistentë të grupeve të deputetëve
		5 evenimente për asistentët e deputetëve në zyrat për kontakt me qytetarët
		30 vullnetarë në Institutin Parlamentar
		20 materiale të reja edukative
1.3	Janë siguruar shërbime bashkëkohore, arkivore, referente, bibliotekare dhe qasje te të dhënat.	
		Digjitalizimi dhe disponueshmëria e 2 milionë dokumenteve nga arkivi legjislativ që nga viti 2024
		34.000 tituj librash në dispozicion të legjislaturës dhe të kërkueshëm në softuerin e bibliotekës elektronike
		250 shfrytëzues të shërbimeve të bibliotekës dhe salla e leximit të IP me 5 evenimente promovuese për bibliotekën
		50 hulumtime të reja tematike proaktive (material referimi)
		riorganizimi i rregullimit hapësinor dhe shpërndarjes së lokacionit të fondit të bibliotekës
		4 baza të të dhënave të disponueshme për shërbimin dhe deputetët (Gazeta zyrtare, Akademika, Praxis dhe De jure)
2.	KUVENDI PËR TË GJITHË	

2.1	Hapja e Kuvendit për publikun	
		35.000 vizitorë në ndërtesën e Kuvendit nëpërmjet 500 ditë të hapura.
		10 “Parlamenti i fëmijëve” për shkollat nëntëvjeçare me 900 pjesëmarrës.
		10 “Seminare” për shkollë e mesme me 300 pjesëmarrës.
		10 “Kam qëndrim” për shkollë e mesme me 500 pjesëmarrës.
		20 “Seminare” për mësimdhënësit e arsimit nëntëvjeçar dhe të mesëm me 600 pjesëmarrës
		2 ditë të hapura familjare në Kuvend me 200 pjesëmarrës gjithsej.
		25 evenimente për festimin e datave dhe ngjarjeve të rëndësishme
		10 materiale informative dhe edukative kushtuar publikut
		5 tryeza të rrumbullakëta për përfaqësues të organizatave të shoqërisë qytetare
		100 postime proaktive në rrjetet sociale dhe faqet e internetit
		5 përmbajtje programore me kanalin televiziv të montimit
		3 Karvanë parlamentare - parlament mobil për komunikim të drejtpërdrejtë të deputetëve me qytetarët

2.2	Përfshirja dhe informimi i të gjitha kategorive të qytetarëve	
		5 evenimente edukative kushtuar persona me handicap në bashkëpunim me IPPG-në
		5 materiale të reja me Alfabetin e Brajrit dhe në format audio.
3.	PARLAMENT DIGJITAL	
3.1	Hapje dhe qasje në shërbimet e Institutit Parlamentar	
		90% të kohës, funksionalitet i pajisjeve harduerike dhe softuerike (vizita virtuale, kuiz e- edukativ, e-seminare, e-trajnim, regjistrim elektronik, e-bibliotekë, e-arkivë, RMS dhe pajisje harduerike dhe serveri)
		Promovim, qasje, përdorim të të gjitha sistemeve softuerike brenda dhe për publikun.
3.2	Digjitalizim i të dhënave dhe statistikave	
		Regjistër i përpiluar i trupave rregullatorë të themeluar nga Kuvendi
		Përpilim i aplikimit për digjitalizim të raporteve dhe statistikave mandatore dhe vjetore
		U siguruan 16 licenca softuerike për përkthim dhe 19 licenca (Canva pro: 9 licenca, Power bio pro: 1 licenca , Adobe creative cloud for teams all apps: 4 licenca, Sound forge pro

		365: 3 licenca, Microsoft Visio plan: 2 licenca, Zoom standard pro: 1 licencë, Kahoot dhe licencë, Autocad 1 licencë)
		Digjitalizimi i regjistrit të akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara (organizimi fillestar me dosje elektronike me mundësinë e zhvillimit të softuerit të specializuar)
		Digjitalizimi i video-arkivës së Kuvendit
		Zhvillimi dhe përmirësimi i zgjidhjeve softuerike
4.	INSTITUT PARLAMENTAR BASHKËKOHOR	
4.1	Qendër e rrjetëzuar për hulumtime, informim dhe edukim.	
		2 punime të përbashkëta kërkimore me shërbime hulumtuese me parlamentet e tjera
		5 memorandume për bashkëpunim me organizata akademike dhe qytetare
		50 të punësuar pjesëmarrës në eventet ECPRD, IFLA, IPU, IPEN, ICA dhe Forumi Ndërkombëtar i Qendrave të Vizitorëve
		2 evente në suazat e organizatave ndërkombëtare të organizuara nga Parlamenti si organizator
4.2	Ekipim, vendosje hapësinore dhe përforcim i kapaciteteve administrative.	

	Plotësim i pozitive vakante të punës në Institutin Parlamentar.
	Hapësira të reja për të punësuarit në Institutin Parlamentar.
	10 përdorues të Programit zviceran për bursa
	25 përdorues të trajnimeve për përsosje
	Mbulimi i të gjitha proceseve të punës me procedurën ISO ose me aktet juridike (udhëzues dhe rregullore).